



Në mbështetje të nenit 64.2 pika (a) dhe (b), neneve 101, 102, 103, 104, 105, 106 dhe 128.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës , neneve 4 ,5 dhe 6 të Ligjit nr. 03/L-256 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/l-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), si dhe nenit 20 dhe neni 29.2 të Ligjit nr. 03/L- 072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (LZL), Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me datën 09.03.2023, miraton këtë:

RREGULLORE NR. 14/2023 QENDRA E NUMËRIMIT DHE REZULTATEVE

Neni 1 Fushëveprimi

Kjo Rregullore përcakton mbikëqyrjen, pranimin dhe kontrollimin fillestar të materialit, kontrollin dhe verifikimin e formularëve të rezultateve, procedurën e numërimit të fletëvotimeve në Qendrën e Numrimit dhe Rezultateve (QNR), verifikimin e zarfeve të fletëvotimeve me kusht dhe zarfeve të fletëvotimeve për votim përmes postës, ankesat lidhur me procesin e punës në QNR, si dhe përpilimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve.

Neni 2 Menaxhimi i QNR

1. QNR menaxhohet nga udhëheqësi i QNR.
2. Gjatë procesit zgjedhor, Kryeshefi Ekzekutiv (KE) i Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (SKQZ) obligohet që të themelojë një trup mbështetës, i cili përbëhet nga këto departamente dhe divizione:
 - 2.1. Departamenti i teknologjisë informative (DTI);
 - 2.2. departamenti i operacioneve zgjedhore (DOZ);
 - 2.3. departamenti i koordinimit në terren (DKT);
 - 2.4. divizioni i trajnimit;

- 2.5. divizioni për shërbim të votuesve.
3. Të gjitha aktivitetet që zhvillohen në QNR, mbikëqyren nga anëtarët e KQZ.
 4. Të gjitha aktivitetet që zhvillohen në QNR, do të vëzhgohen nga vëzhguesit dhe mediat të akredituara.
 5. Brenda QNR, jo më tepër se katër (4) vëzhgues të akredituar nga e njëjta organizatë e akredituar, mund të jenë të pranishëm njëkohësisht, për të vëzhguar zgjedhjet.
 6. Subjektet politike obligohen që të dërgojnë listën e vëzhguesve që do të vëzhgojnë procesin brenda QNR.
 7. Pa marrë parasysh dispozitat e kësaj Rregulloreje, nëse KE SKQZ sipas gjykimit të tij/saj të lirë dhe me kërkesë të udhëheqësit të QNR, konstaton se numri i vëzhguesve të akredituar të zgjedhjeve ose i përfaqësuesve të mediave të akredituara të pranishëm në QNR është duke e penguar procesin, ai/ajo duhet t'i udhëzojë vëzhguesit dhe/ose përfaqësuesit e mediave që të zvogëlojnë numrin e tyre.

Neni 3

Pranimi dhe kontrollimi fillestar i materialit

1. Pas marrjes së materialit nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve (KKZ), personeli i QNR duhet të pranojë formularin e përputhjes së rezultateve (FPR), formularin e rezultateve të kandidatëve (FRK), listën përfundimtare të votuesve (LPV), listën e votuesve me kusht (LVK), librat e votimit dhe kutitë e mbyllura të votimit. Numrat e shiritave mbyllës të kutive të votimit duhet të verifikohen. Personeli i QNR duhet të shënojë secilin artikull të pranuar ose që mungon në raportin e pranimi të QNR.
2. Personeli i QNR duhet të bëjë auditime dhe hetime përkitazi me materialet e pranuar, sipas paragrafit 1 të këtij neni, nëse:
 - 2.1. Nuk mund të përcaktohet numri i vendvotimit (VV), i materialeve të pranuar dhe/ose mungon një FPR, FRK, LPV;
 - 2.2. ka ndonjë parregullsi ose shmangie të tjera nga procedurat ligjore.
3. KKZ duhet të dorëzojë të gjithë materialin zgjedhor në QNR, nën përcjelljen e policisë.
4. Në rast se gjatë pranimi të materialit nga personeli i QNR, evidentohet se mungon ndonjë material zgjedhor, atëherë KKZ nga komuna përkatëse duhet të sjellë materialin që mungon, brenda 12 orëve nga njoftimi për mungesë.

5. KKZ i cili e përcjell materialin në QNR lejohet ta lëshojë hapësirën e QNR, nëse të gjitha procedurat e dorëzimit janë përfunduar dhe personeli përgjegjës i QNR e informon atë se mund të largohet. Anëtar i KKZ që largohet para se të marrë lejen, sanksionohet në bazë të Rregulloreve të KQZ.
6. Udhëheqësi i divizionit të shërbimit të votuesve duhet t'ia dorëzojë udhëheqësit të QNR zarfet e fletëvotimeve për votim përmes postës, pas procesimit të tyre sipas Rregullore Nr.06/2023 regjistrimi dhe votimi jashtë Kosovës.

Neni 4

Futja e të dhënave, kontrolli dhe verifikimi i formularëve të rezultateve

1. Personeli i QNR regjistron në sistem të dhënat nga të gjithë formularët e rezultateve.
2. Niveli i lejuar i mospërputhjeve aplikohet sikurse gjatë numërimit në VV, për të cilin njoftohet KQZ .
3. Në rast të mospërputhjes së të dhënave mbi nivelin e tolerancës, personeli i QNR duhet të kontrollojë dhe verifikojë saktësinë e të dhënave të shënuara në formularë të rezultateve, aty ku konstatohet mospërputhja, duke krahasuar:
 - 3.1. Numrin e përgjithshëm të fletëvotimeve të rregullta të gjetura në kutinë e votimit me numrin e përgjithshëm të nënshkrimeve në LPV;
 - 3.2. numrin e ZFK të gjetura në kutinë e ZFK, me numrin e nënshkrimeve në LVK;
 - 3.3. numrin total të votave të vlefshme dhe të pavlefshme, me numrin e votave të rregullta të gjetura në kutinë e votimit;
 - 3.4. numrin total të fletvotimeve të papërdorura, të fletvotimeve të dëmtuara, të fletëvotimeve të rregullta të gjetura në kutinë e votimit, ZFK të gjetura në kutinë e ZFK me numrin e fletëvotimeve të pranuar;
 - 3.5. Numri i votave të vlefshme, me numrin e përgjithshëm të votave të subjekteve politike;
 - 3.6. Numri i votave të subjektit, krahasuar me numrin e votave të kandidatëve.
4. Në rast se pas kontrollit dhe verifikimit që është bërë sipas paragrafit 3 të këtij neni, nuk zgjidhet problemi i identifikuar, udhëheqësi i QNR i paraqet rekomandim KQZ për vendimmarrje.
5. Deri në vendimmarrjen e KQZ, materiali i mbajtur për verifikim deponohet në një vend të sigurtë, me qasje të kufizuar në QNR.

Neni 5

Regjistrimi dhe verifikimi i zarfeve të fletëvotimeve me kusht dhe i zarfeve të fletëvotimeve për votim përmes postës

1. Zarfet e fletëvotimeve me kusht (ZFK) dhe zarfet e fletvotimeve të personave me nevoja të veçanta (VPNV), të cilat kanë të shënuara të dhënat e votuesve, procedohen për regjistrim.
2. Personeli i QNR verifikon ZFK dhe zarfin e VPNV, nëse:
 - 2.1. Emri i votuesit gjendet në LPV ose në ekstraktin e fundit të një dite para zgjedhjeve;
 - 2.2. Votuesi nuk ka votuar në VV të rregullt, VV tjetër me kusht, VPNV apo përmes postës;
 - 2.3. votuesi nuk ishte përjashtuar nga LPV, me vendim të Gjykatës.
3. QNR numëron vetëm fletëvotimet nga zarfet e konfirmuara të ZFK, VPNV dhe përmes postës.
4. Personeli i QNR-së i hap ZFK e konfirmuara:
 - 4.1. Refuzon ZFK, nëse gjendet i zbrazët;
 - 4.2. refuzon ZFK, nëse përmban më shumë se një zarf të fshehtësisë.
 - 4.3. QNR hapë zarfet e fshehtësisë të konfirmuara të votimit me kusht, VPNV dhe të zarfeve të votimit përmes postës, konfirmon nëse zarfi i fshehtësisë përmban fletëvotimin/et për zgjedhjen/et përkatëse, nëse votuesi është regjistruar në komunën për të cilën ai/ajo ka votuar.
5. QNR refuzon zarfin e fshehtësisë, nëse:
 - 5.1. Nuk përmban fletëvotim;
 - 5.2. përmban me shumë se një fletëvotim për zgjedhjet përkatëse.
 - 5.3. votuesi nuk është regjistruar në komunën për të cilën ai/ajo ka votuar në zgjedhjet lokale.

Neni 6

Numërimi i fletëvotimeve në QNR

1. Fletëvotimet e gjetura brenda zarfeve të pranuar të fshehtësisë të konfirmuara, si dhe çfarëdo fletëvotimi tjetër që kërkohet të numërohet me vendim të KQZ ose të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa (PZAP), numërohen në QNR.

2. Fletëvotimi konsiderohet i pavlefshëm, nëse:
 - 2.1. Është shënjuar më shumë se një subjekt politik;
 - 2.2. mënyra se si është shënjuar fletëvotimi e bën qëllimin e votuesit të paqartë;
 - 2.3. nuk është vëlosur me vulën zyrtare të fletëvotimeve, përveç nëse është fletëvotim për votim përmes postës, i cili nuk kërkohet të vëloset;
 - 2.4. nëse nuk është fletëvotim i aprovuar nga KQZ;
 - 2.5. fletëvotimi që nuk është i shënjuar.
3. Rezultatet e procesit të numërimit duhet të shënohen në FRP dhe FRK, të përshtatur për këtë proces.

Neni 7

Ankesat për procesin në QNR

Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QNR, bëhen në pajtim me nenin 105 të LPZ-së dhe nenit 26 të LZL.

Neni 8

Rezultatet e zgjedhjeve

1. QNR, gjatë tabulimit të formularëve, në mënyrë të vazhdueshme publikon rezultatet e votave të subjekteve politike dhe të kandidatëve.
2. Pasi të jenë shqyrtuar dhe vendosur të gjitha ankesat e mbetura përkitazi me votimin dhe numërimin nga organet kompetente dhe, pasi të jetë marrë ndonjë masë e kërkuar nga KQZ, personeli i QNR duhet të nxjerrë totalin e rezultateve të të gjitha FPR, FRK dhe FRD të pranuar dhe të përpilojë rezultatet e zgjedhjeve.
3. KQZ mund të urdhërojë rinumërimin e votave, në rast të mospërputhjes së rezultateve.
4. KQZ shpallë rezultatet përfundimtare pas përpunimit të të gjitha formularëve të rezultateve.
5. Pas shpalljes së rezultateve përfundimtare, është në kompetencë të PZAP, bazuar në ankesa, të anulojë rezultatet në një VV apo QV, dhe ta urdhërojë KQZ të përsëritë votimin në një VV apo QV.
6. KQZ certifikon rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, pas përfundimit të të gjitha procedurave nga PZAP dhe nga Gjykata Supreme.

7. Në bazë të rezultateve të certifikuara, KQZ përgatitë listën e të gjitha mandateve për zgjedhjet e certifikuara dhe ia paraqet Presidentit të Kosovës dhe institucioneve përkatëse.

Neni 9
Procedurat e QNR

Me qëllim të rregullimit të veprimeve me të detajuara të QNR, KQZ miraton procedurat e QNR.

Neni 10
Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregulla zgjedhore Nr.06/2013 qendra e numrimit dhe rezultateve.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga KQZ.

Kryesues
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi